


Manual: Shkarkimi dhe instalimi i aplikacionit Teleshëndet



Përmbajtja

1. Informacioni i përgjithshëm
2. Instalimi
 - 2.1. Shkarkimi
 - 2.2. Regjistrimi
3. Konsultimi me video
4. Kartela mjekësore
 - 4.1. Shkarkoni kartelën
 - 4.2. Ngarkoni dokumenta mjekësore
5. Rimbursimi i shpezimeve shëndetësore
6. Përfitimet shtesë

1. Informacion i përgjithshëm

Shërbimi i ri Teleshëndet nuk zëvendëson konsultimin mjekësor personal apo një vizitë në urgjencë në raste kur është e domosdoshme vëmendja mjekësore emergjente. Lidhur me COVID-19, telemjekësia mund të ulë rrezikun e transmetimit tek pacientët e tjerë dhe stafi i kujdesit shëndetësor. Gjithashtu, ajo ndihmon për të ruajtur burimet mjekësore në kohët në nevojë.

Si funksionon një konsultim mjekësor me video?

Konsultimi mjekësor/shëndetësor përmes celularit është një formë e re e kujdesit mjekësor: tani pacientët mund të shohin doktorin e tyre në kohë reale, pa qenë nevoja për të dalë nga shtëpia e tyre. Doktorin e shohin ata dhe ata e shohin doktorin e tyre – duke mundësuar kështu sqarimin dhe konsultimin e shpejtë dhe të saktë, madje edhe nga shtëpia. Partnerët tanë mjekësor nga Teleshëndet janë specialistë me përvojë. Një bashkëbisedim personal në kombinim me një vlerësim pamor formojnë elementët kyç të konsulimit virtual.

Kë mund të ndihmojë ky shërbim?

- Ky shërbim ofrohet për këdo dhe nuk ka limit moshe

Kur është i disponueshëm shërbimi Teleshëndet?

- Nga e hëna në të diel (duke përfshirë pushimet zyrtare), 24 orë

A mund ta përdorë këtë shërbim në rast se dyshoj se jam infektuar me koronavirus?

Ky shërbim **nuk synon trajtimin e rasteve të dyshuara apo të konfirmuara me koronavirus**. Në koordinim me autoritetet shqiptare, ne këshillojmë që njerëzit e infektuar të qëndrojnë në shtëpi dhe të kontaktojnë me shërbimet shëndetësore publike. Nëse dyshoni se mund të jeni të infektuar, ju lutem telefononi mjekun tuaj të familjes.

Në rast sëmundje që kërcënojnë jetën apo të dëmtimeve serioze, ju lutem telefononi numrin e përgjithshëm të emergjencës **112!**



JU LUTEM VINI RE: Për të përdorur shërbimin Teleshëndet, kërkohet shkarkimi dhe instalimi i një aplikacioni i cili është i disponueshëm në Playstore dhe Appstore
Shërbimi ofrohet falas për 24 orë kur shkarkoni për herë të parë aplikacionin. Nëse doni të keni shërbimin më tej duhet ta blini atë.

2. Instalimi

Për të instaluar aplikacionin Teleshëndet në celularët tuaj dhe për t'u regjistruar për një konsultim me video, ju lutem referohuni udhëzimeve të mëposhtme hap pas hapi. Informacion i mëtejshëm është i disponueshëm në <https://sigal.com.al/teleshendet/>.

2.1 Shkarkimi

Shkarkoni aplikacionin Teleshëndet nga Apple Store apo Google Play këtu:


Sistemi	Linku
Android	https://play.google.com/store/apps/details?id=app.sigal.telemjek
Apple	https://apps.apple.com/us/app/teleshendet/id1559751905

Aplikacioni mund të shkarkohet falas dhe është i disponueshëm për të gjithë celularët e zakonshëm!



2.2 Regjistrimi

Ndiqni hapat e regjistrimit të aplikacionit dhe filloni!

1.) Hapni aplikacionin dhe zgjidhni “Regjistrohu”




2.) Zgjidh Krijë një profil të ri dhe plotësoni informacionin personal (emri, mbiemri, celular, ditëlindja, email dhe gjininë)



3.) Në email ju vjen një kod regjistrimi




4.) Rihyni në aplikacion me email dhe fjalëkalim




4.) Si të aktivizoni paketën e shërbimit 24 orë falas?

(Shkoni tek profili im, regjistrimi im dhe zgjidh kerko një abonim provë)




5.) Si të aktivizoni paketën Teleshëndet?

Hapat e mëposhtëm tregojnë hapat e aktivizimit të paketës kur keni blerë kartë Teleshëndet. Kur aktivizimi është i suksesshëm shfaqet statusi aktive dhe ditët e mbetura të shërbimit.



6.) Si të aktivizoni paketën Teleshëndet kur ke kartë Sigurimi Shëndeti Gold ose Silver?

Hapat e mëposhtëm tregojnë hapat e aktivizimit të paketës kur keni kartë sigurimi shëndeti SIGAL Gold ose Silver. (tek hapi 4 vendosni nr e kartes pas slash) Kur aktivizimi është i suksesshëm shfaqet statusi aktive dhe ditët e mbetura të shërbimit.




7.) Informacioni bazë në ekran sapo hyni në aplikacion

Pas kyçjes së parë, do të shfaqet informacioni i përgjithshëm rreth aplikacionit (ky hap mund të kalohet).

3. Konsultimi me video

Tani ju jeni gati për konsultimin tuaj mjekësor/shëndetësor nëpërmjet celularit! Filloni telefonatën duke shtypur **simbolin e telefonit** në ekranin kryesor. Pas një kohe të shkurtër në linjë, një ekspert i Teleshëndet do të lidhet me ju për t'ju ndihmuar me problemin tuaj.




VINI RE: Ju mund të flisni me mjekun për atë periudhë që keni aktivë shërbimin në telefonin tuaj!


4. Kartela mjekësore

Pasi përfundoni këshillimin, mjeku plotëson kartelën tuaj mjekësore.

4.1 Si të printoni kartelën tuaj mjekësore




4.1 Si të ngarkoni dokumenta mjekësor që ti konsultojë mjeku i Teleshëndet



5.

5. Rimbursimi i shpenzimeve shëndetësore

Klientët me kartë shëndeti Silver dhe Gold kanë mundësi të ndjekin në aplikacion rimbursimet e shpenzimeve mjekësore




6. Përfitime shtesë

Klientët e Teleshëndet me paketë individuale apo familjare kanë edhe përfitime të tjera shtesë të cilat përditësohen vazhdimisht.

Ju mund ti shikoni ato në aplikacion

Ose në linkun



<https://sigal.com.al/teleshendet/#oferta-teleshendet>